

ana e KNKK-së. Rasti i tij është i sistemuar në lëndën me numër BLG-804736-01.

Burimet: deklarata A.M, FDH-15607; FHP, *Spisak nestalih lica iz perioda jul-avgust 1998*, FDH-859; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Sefullah (Jetullah) Muliqi

(26.11.1981, shqiptar nga Obria e Epërme/ Gornje Obrinje, komuna e Gllgocit/Glogovac)

Sefullahu dhe familja e tij prej shtatë anëtarëve kanë jetuar në fshatin Obri të Epërme/Gornje Obrinje. Shoqërohej me ushtarët [UÇK] dhe, në ndërkohë, merrej me bujqësi. Në mëngjesin e datës **19.08.1998**, Sefullahu ka shkuar te daja i vet Musa, në Mitrovicë/Kosovska Mitrovica, për të marr makinën e tij. Në mbrëmje, Sefullahu me djalin e Musës, Bedriun dhe mikun e tij u nisën për në Obri të Epërme/ Gornje Obrinje. Sefullahu e ngjeste makinën. Me të në makinë ishte miku i Bedriut, përderisa ky e ngjeste kamionin që ishte pas tyre. U ndalën në **Shtuticë/Štutica** dhe bashkudhëtari i Sefullahut kaloi te Bedriu në kamion. I ngjasin makinat pa drita dhe pas një vozitjeje të gjatë në terr u ndan aksidentalisht. Atë mbrëmje, Sejfullahu nuk kishte arritur në shtëpi. Familjarët nuk dinin asgjë për fatin e tij deri në muajin janar 1999, kur ata, falë rrobave të tij të trupit, e identifikuan Sefullahun, mbetjet mortore e të cilit u gjenden në njërin nga pesë varre që u hapën në Suhodoll/Suvi Do [Mitrovicë/Kosovska Mitrovica]. Kufoma e tij ka mbetur atje deri në nëntorin e vitit 2002, kur Zyra e UNMIK-ut për Persona të Zhdukur e kishte kryer zhvarrimin e varreve në Suhodoll/Suvi Do. Në verë të vitit 2003, familjarëve u është bërë të ditur zyrtarisht se analiza ADN e ka konfirmuar identitetin e Sefullahut. Në datën 13.08.2003, familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Sefullahut në varrezat e *Mëhallës Muliqi*, në Obri të Epërme/ Gornje Obrinje.

Burimi: deklarata R.M, FDH-28130.

Goran (Velimir) Milenković

(8.01.1971, serb nga Lipjani/Lipljan, pjesëtar i

MPB-së së Republikës së Serbisë)

Gorani me origjinë ishte nga Gushterica e Ulët/Donja Gušterica [Lipjan/Lipljan]. E kishte mbaruar shkollën e mesme. Ishte pjesëtar i forcave shtesë së policisë serbe nga viti 1998. Në datën **20.08.1998**, nga ora 23:00, ka rënë në betejë me forcat e UÇK-së, e cila u zhvillua në **Llapushnik/Lapušnik**.

Burimet: SMIP, *Teroristički...*, III, 478, 938; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 42; KKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; *Pjesëtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme – viktimat e terrorizmit shqiptar në vitin 1998...*, na <http://www.srbija-info.yu/vesti/1999-02/19/9769.html>, FDH-31078; *Dnevnik od 19. do 25. avgusta*, Ilustrovana politika, FDH-29547.

Rrahim (Alush) Hykollli

(1923, shqiptar nga Kizharekë/Kišna Reka, komuna e Gllgocit/Glogovac, gjashtë fëmijë)

Rexhep (Alush) Hykollli

(1936, shqiptar nga Kizharekë/Kišna Reka, komuna e Gllgocit/Glogovac, punëtor ndërtimor, pesë fëmijë)

Kur forcat serbe, më 26.07.1998, e sulmuan **Kizharekën/Kišna Reka**, vëllezërit Rexhepi dhe Rrahimi vendosën të qëndronin në shtëpinë e vet, përderisa djali i Rexhepit dhe familjarët e tjerë u larguan dhe u strehuan në *Mëhallën Mrizet*. Familjarët e vizitonin Rexhepin dhe Rrahimin për çdo natë deri në datën 16.08.1998, kur forcat serbe e kryen një sulm të furishëm kundër fshatit. Në datën 26.08.1998, djali i Rexhepit, Blerimi, ka mësuar nga i afërmi i tij Sylja se ai, në mëngjes të datës **23.08.1998**, e kishte takuar Rrahimin dhe Rexhepin në fshat. Në të njëjtën mbrëmje, Sylja i ka gjetur trupat e tyre të pajetë në fushën e quajtur *Dushku*. Familjarët e kanë varrosur Rrahimin dhe Rexhepin në varrezat e *Mëhallës Mrizet*.

Burimi: deklarata B.H, FDH-20230.

Asllan (Ramë) Vilaku

(28.05.1953, shqiptar nga Komarani/Komorane, komuna e Gllgocit/Glogovac, punëtor ndërtimor, gjashtë fëmijë)

Në datën **23.08.1998**, forcat serbe e kanë